Funded by the European Union

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented by the Council of Europe

# Projekti kundër korrupsionit në Shqipëri (PACA)

# Aktivitete të përzgjedhura të Planit të Punës (për periudhën e zgjatjes së projektit)

Referenca: IPA 2008

| | |
|---|---|
| Titulli i projektit: | **Projekti kundër korrupsionit në Shqipëri (PACA)-EXT** |
| Vendi i projektit : | **Shqipëria** |
| Emri i agjencisë zbatuese | **Këshilli i Europës** |
| Kohëzgjatja | **10 muaj (1 mars – 31 dhjetor 2012)** |

*(Version i 29 shkurtit 2012)*

| | | | |
|---|---|---|---|
| **OBJEKTIVI I PËRGJTITSHËM: TË KONTRIBUOJË PËR DEMOKRACINË DHE SHTETIN E SË DREJTËS NËPËRMJET PARANDALIMIT DHE KONTROLLIT TË** | | | |
| **Qëllimi: Të forcojë zbatimin e Strategjisë Anti- korrupsion 2007-2013 dhe të Plan-Veprimit Anti-korrupsion 2011-2013** | | | |
| **Rezultati i pritshëm 1** | **Treguesit objektivisht të verifikueshëm (TOV)** | **Mjetet e Verifikimit** | **Risqet dhe supozimet** |
| **Institucionet, mbi bazën e Udhëzuesit të Vlerësimit të Riskut të PACA-s, janë në gjendje të identifikojnë problemet dhe rreziqet e lidhura me korrupsionin dhe të zhvillojnë politika për të trajtuar gjetjet dhe rekomandimet e vlerësimeve të riskut të mëparshme ;** | **Vlerësimi i kryer<br>Workshop-et/trajnimet e kryera<br>Prania e përfaqësuesve të PACA-s në grupet e punës për reformat<br>Propozime konkrete mbi politikat për zbatimin e rekomandimeve të vlerësimit të riskut** | | |
| **Aktivitetet** | **Veprimet** | **Kuadri kohor** | **Gjendja** |
| 1.1 Vlerësimet ekzistuese të riskut në institucione të kryera nga DEKOBAN dhe trajnime mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut | Shqyrtimi i vlerësimeve ekzistuese të riskut të institucioneve të kryera nga DEKOBAN<br><br>Mbajtja e dy workshop-eve/trajnimeve mbi metodat e vlerësimit të riskut | Mars-Maj 2012<br><br>Qershor 2012 | |
| 1.2 Ndjekje e punës sipas nevojës me përfituesit e vlerësimeve të riskut për të zhvilluar plan veprime / politika anti-korrupsion mbi bazën e vlerësimeve të riskut të kryera më herët | Mbështetje Ministrisë së Shëndetësisë për zbatimin e rekomandimeve të zgjedhura të vlerësimit të riskut të kryer nga PACA [KËRKESË PARAQITUR MINISTRISË SË SHËNDETËSISË]<br><br>Mbështetje Ministrisë së Drejtësisë për hartimin e politikave për reformën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në zbatim të rekomandimeve të PACA-s. | Mars 2012<br><br>Prill-Dhjetor 2012 | |
| **Rezultati i pritshëm 2** | **Treguesit objektivisht të verifikueshëm (TOV)** | **Mjetet e Verifikimit** | **Risqet dhe supozimet** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Disponimi i mjeteve/instrumenteve për mbajtjen dhe raportimin e statistikave mbi hetimet, ndjekjet penale dhe çështjet në gjykatë të rasteve në lidhje me korrupsionin. Përmirësimi i mjeteve/instrumenteve të parashikuara për riorganizimin e mekanizmit koordinues për raportimin dhe monitorimin e zbatimit e plotësimit të Strategjisë Anti-korrupsion është përmirësuar;.** | | | |
| **Aktivitetet** | **Veprimet** | **Kuadri kohor** | **Gjendja** |
| 2.1 Ofrimi i këshillave, udhëzimeve, dhe modeleve për mbledhjen, përpunimin dhe regjistrimin e statistikave dhe informacioneve të tjera mbi korrupsionin mbi korrupsionin dhe rastet e lidhura me korrupsionin | Vlerësimi i sistemit ekzistues për mbledhjen, dhe regjistrimin e statistikave dhe informacioneve të tjera mbi korrupsionin dhe,<br><br>Kryerja e vlerësimit të sistemit ekzistues për mbledhjen, përpunimin dhe regjistrimin e statistikave dhe informacioneve të tjera mbi korrupsionin dhe rastet e lidhura me korrupsionin, nga zbulimi fillestar / njoftimi i vendimit përfundimtar, duke marrë parasysh konstatimet dhe rekomandimet e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC 'Zhvillimi i instrumenteve të monitorimit për institucionet e drejtësisë dhe ligjzbatuese në Ballkanin Perëndimor), të Projektit dhe të rezultateve të tjera të asistencës teknike mbi statistikat e krimit<br><br>Formulimi i rekomandimeve specifike për sistemin e raportimit statistikor, duke përfshirë modelet dhë mënyrat e bashkëpunimit (e.g. p.sh marrëveshjet e mirëkuptimit).<br><br>Takim/event publik për shpërndarjen, diskutimin e sistemit të raportimit të propozuar me përfituesit | | |
| 2.2 Asistencë në përdorimin e mjeteve software ekzistuese (software për përgatitjen dhe raportimin e Planit Kombëtar | Vlerësim i përshtatshmërisë së mjeteve software ekzistues të qeverisë shqiptare për të raportuar mbi | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| për zbatimin e MSA-së) për të lehtësuar nevojat e raportimit dhe monitorimit të subjekteve raportuese shqiptarë (ministritë e linjës dhe institucionet e tjera) dhe të mekanizmit monitorues (Grupi Ndërministror i Punës për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Anti-korrupsion dhe Sekretariati Teknik i tij) | zbatimin e Planit të Veprimit. | | |
| **Rezultati i pritshëm 3** | **Treguesit objektivisht të verifikueshëm (TOV)** | **Mjetet e Verifikimit** | **Risqet dhe supozimet** |
| **Përmirësimi i legjislacionit dhe zbatimit të tij në përputhje me rekomandimet e GRECO, MONEYVAL, Bashkimit Europian dhe me praktikat më të mira;** | | | |
| | **Veprimet** | **Kuadri kohor** | **Gjendja** |
| 3.1 Përcaktimi i aktivitetit/eteve, duke përfshirë asistencën legjislative për Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e rekomandimeve të GRECO, MONEYVAL (duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar / ndihmë ligjore të ndërsjelltë për çështjet e lidhura me veprën penale të korrupsionit dhe kthimin e aseteve) | Kryerja e shqyrtimit të përputhshmërisë së amendamenteve të propozuara në Kodin Penal në lidhje me financimin e terrorizmit, me rekomandimet MONEYVAL, me rekomandimet e veçanta (paragrafët e propozuara ligjore) për ndryshime të amendamenteve.<br><br>Shqyrtimi i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, dhe të Ligjit për Parandalimin e Terrorizmit, për përputhsmërinë e tyre me rekomandimet e Raportit të Roundit të Katërt të MONEYVAL | | |
| 3.2 Rishikimi dhe përmirësimi i kornizave legjislative / rregullatore dhe institucionale që trajtojnë rekomandimet dhe çështjet e theksuara në Raportin e Progresit të Bashkimit Europian për Shqipërinë | Identifikimi i fushave për shqyrtim në lidhje me Planin e Veprimit të Qeverisë Shqiptare për përmbushjen e Prioritet 8 të Opinionit të BE-së për aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në BE<br><br>Dhënie e komenteve / vlerësimeve të fushave të | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | përzgjedhura, duke përfshirë rekomandimet specifike (p.sh. paragrafët legjislativë)<br><br>Ndihmë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive për të krijuar mekanizma funksionale për dhënien e informacionit nga institucionet kryesore, duke përfshirë edhe Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë [PER T'U SHTJELLUAR] | | |
| **Rezultati i pritshëm 4** | **Treguesit objektivisht të verifikueshëm (TOV)** | **Mjetet e Verifikimit** | **Risqet dhe supozimet** |
| **Adoptimi politika që i kundërvihen korrupsionit dhe i mëshojnë integritetit në sistemin arsimor, krijimi i mjeteve/instrumenteve që i kundërvihen korrupsioni përmes sistemit arsimor** | | | |
| | **Veprimet** | **Kuadri kohor** | **Gjendja** |
| 4.1 Këshillim për politikat për të vijuar me veprime në zbatim të rekomandimeve të PACA-s të shprehura në ''Vlerësimin e riskut në sistemin arsimor/burimet njerëzore dhe në 'Vlerësimin e rregullimit të institucioneve të arsimit privat', duke përfshirë finalizimin e Kodit të Sjelljes | Takim-Workshop me përfaqësues të Institutit për Zhvillimin e Arsimit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për të diskutuar projek-Kodin e Sjelljes ekzistues<br><br>Dhënia e rekomandimeve (të paragrafuara) specifike për ndryshime në projekt –Kodin e Sjelljes, bazuar në rekomandimet e mëparshme të PACA-s<br><br>Takim-Workshop me zyrtarët përkatës (nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe organet përkatëse të inspektimit) për të përcaktuar nevojat për hartimin e rregullave dhe procedurave për procesin e inspektimeve të institucioneve arsimore private. | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Sigurimi i manualeve të inspektimit të propozuara për Inspektoratin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, dhe grupeve të punës të ministrisë për inspektimin e institucioneve të arsimit të lartë. | | |
| 4.2 Pilotimi dhe përmirësimi i manualit të kurrikulës ‘’Edukimi kundër korrupsionit’’ | Workshop për të për të bërë trajnimin për maketin e manualit të kurrikulës ‘'Edukimi kundër korrupsionit'’ dhe për shpërndarjen e tij<br><br>Workshop pas pilotimit të manualit, për të marrë dhe shtjelluar reagimet e mësuesve mbi maketin e manualit<br><br>Përditësimi i manualit, shtypja e tij dhe paraqitja e versionin përfundimtar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës | | |
| **Rezultati i pritshëm 5** | **Treguesit objektivisht të verifikueshëm (TOV)** | **Mjetet e Verifikimit** | **Risqet dhe supozimet** |
| **Ngritja e dhe vënia në punë e sistemeve funksionale për marrjen, përpunimin dhe ndjekjen e ankesave të** | | | |
| | **Veprimet** | **Kuadri kohor** | **Gjendja** |
| 5.1 Vlerësimi i kornizës aktuale ligjore (duke përfshirë Ligjin për Bashkëpunimin e Publikut në Luftën Kundër Korrupsionit) dhe i mekanizmave praktikë për lehtësimin e ankesave dhe denoncimeve lidhur me korrupsionin ose keqpërdorimeve të tjera të detyrës nga zyrtarët publikë /nëpunësit e shërbimit civil | Vlerësimi me shkrim i kuadrit aktual ligjor dhe nën-ligjor që rregullon paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave të qytetarëve kundër korrupsionit dhe sjelljes së nëpunësve publik, duke përfshirë Kodin e Procedurës Administrative dhe Ligjin për Bashkëpunimin e Publikut në Luftën Kundër Korrupsionit<br><br>Ofrimi i rekomandimeve specifike për ndryshimet në kuadrin ligjor dhe nën-ligjor | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Rezultati i pritshëm 6** | **Treguesit objektivisht të verifikueshëm (TOV)** | **Mjetet e Verifikimit** | **Risqet dhe supozimet** |
| **Ofrimi i rekomandimeve dhe ndërmjetësimi i diskutimeve të propozimeve për reformimin e kuadrit ligjor dhe institucional për të siguruar aksesin në informacion** | | | |
| | **Veprimet** | **Kuadri kohor** | **Gjendja** |
| 6.1 Kryerja e vlerësimit të kuadrit ligjor dhe institucional ekzistues që rregullon aksesin në informacion | Hartimi i një dokumenti teknik që bën vlerësimin e kuadrit ligjor dhe institucional ekzistues që rregullon aksesin publik në informacion | | |
| 6.2 Një forum publik mbi Aksesin në Informacion që të dalë me rekomandime konkrete mbi politikat nga OJQ-të | Organizimi dhe mbajtja e një forumi publik mbi aksesin në informacion | | |
| **Rezultati i pritshëm 7** | **Treguesit objektivisht të verifikueshëm (TOV)** | **Mjetet e Verifikimit** | **Risqet dhe supozimet** |
| **Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për çështje të korrupsionit dhe politikave qeveritare antikorrupsion.** | | | |
| 7.1 [PËR T'U SHTJELLUAR] | | | |
| | | | |